

Emri i Lëndës : E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme e Avancuar							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 431	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Altin Shegani, Prof. Dr.					
Asistenti		Erisa Datja, MSc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Lënda e Drejtë Penale e Avancuar është lëndë e formimit bazë të detyrueshëm e cila synon të zhvillojë dhe thellojë më tej njohuritë në lidhje me problematikat bashkëkohore të aplikimit të përgjegjësisë penale për vepra penale të veçanta dhe nga më komplekset me të cilat përballet realiteti shqiptar dhe ai botëror. Çështje të tilla si: zbatimi i përgjegjësisë penale mbi shoqëritë tregtare për vepra penale të kryera prej tyre, mbrojtja juridiko-penale e të drejtës për jetë private, veprat penale me qëllime terroriste do të prezantohen në një kombinim të vazhdueshëm të aspekteve teorike dhe praktike					
Objektivat							
Konceptet Kryesore		1. E drejta penale 2. Konventa 3. Ligji huaj 4. Sisteme ligjore					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Veprat penale në shoqëritë tregtare Probleme aktuale të përgjegjësisë penale të shoqërive tregtare;						
2	Analizë e kushteve të përgjegjësisë penale të personave juridikë						
3	Mekanizmat e nevojshëm ligjorë për zbatimin e përgjegjësisë penale ndaj shoqërive tregtare						
4	Kategoritë e personave fizikë që mund të shkaktojnë lindjen e përgjegjësisë penale të shoqërisë tregtare						
5	Analizë e natyrës ndërvepruese shoqëri-punëmarrës dhe e ndikimit të saj në aplikimin e përgjegjësisë penale						
6	Llojet e veprave penale për të cilat mund të mbajë përgjegjësi një shoqëri tregtareVeçoritë e kriminalitetit të shoqërive tregtare						
7	Studim i rasteve të mbarimit, bashkimit dhe ndarjes së shoqërive tregtare dhe zgjidhjes së çështjes së përgjegjësisë penale						
8	Provim Gjysmëfinal						
9	Analizë e dënimeve të zbatueshme ndaj një shoqërie tregtare përgjegjëse për kryerjen e veprës penale dhe e procedurës së aplikimit të tyre						
10	Vështrim krahasues i përgjegjësisë penale të shoqërive tregtare sipas legjisllacioneve të vendeve të tjera evropiane: Franca, Anglia, Italia, Gjermania, Holanda, Spanja						
11	Referim në raportet zyrtare të shteteve të tjera në idhje me format e shfaqjes së veprimtarisë kriminale të personave juridikë; Prezantim i rasteve të përzgjedhura të jurisprudence së huaj mbi përgjegjësinë penale të shoqërive tregtare						
12	E drejta penale anti-terroriste : kuadri historik i shfaqjes së fenomenit terrorist dhe legjisllacionit anti-terrorist, heterogjeniteti dhe ambiguiteti i definicioneve, teknikat e inkriminimit të akteve terroriste, tipologjia e veprave penale me qëllime terroriste, natyra e sanksioneve, sanksionet për personat fizikë dhe juridikë, masat e ndërmarra në luftën kundër terrorizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar						

13	E drejta penale e jetës private : Koncepti i jetës private, mbrojtja juridiko-penale që i sigurohet jetës familjare, paprekshmërisë së banesës, fshehtësisë së korrespondencës, lirisë së shprehjes së bindjeve fetare, të drejtës për ruajtjen e imazhit etj
14	Veçoritë që paraqet vepra penale e shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës në kushtet e zhvillimeve më të fundit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), elementë taktikë të realizimit të veprës penale të ndërhyrjeve të padrejta në jetën private dhe përgjigjja e legjislacionit penal ndaj situatave të tilla faktike. Përshkrim i veçorive të veprave që lidhen me vjedhjen e identitetit virtual
15	E drejta penale e pronësisë intelektuale dhe informimit : Koncepti i pronësisë intelektuale, mbrojtja juridiko-penale e pronësisë intelektuale, kushtet për inkriminimin e veprimeve të ndryshme që prekin të drejtën e pronësisë intelektuale, veçoritë e konsumimit të këtyre veprimeve në mjedisin kibernetik
16	Provim Final
Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Elezi, I. (2008)E Drejta Penale: Pjesa e Posaçme, Tiranë : ERIK
Referenca të tjera	• Toren. P.(2005) Intellectual Property and Computer crimes. New York: Law Journal Press - Pablo Antonio Fernandez -Sanchez.(2009) International Legal Dimension of Terrorism. Boston: Martinus Nijhoff Publishers • Gilbert, G. Pontell,H.(2007) International Hanbook of White-Collar and Corporate Crime. Dordrecht: Springer • Pieth, M. Radha I.(2011)Corporate Criminal Liability: Emergence, Convergence, and Risk. Dordrecht: Springer • Claes, E. Duff, A, Gutwirth, S. (2006)Privacy and the Criminal Law. Antwerpen: Intersentia,. • Shegan,A. (2010) La lutte contre le terrorisme : étude de droit comparé (droit français, droit albanais) et de droit pénal international, Tezw doktrature, France : Universiteti Bordeaux IV
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të jenë në gjendje të njohin figurat e veprave penale të veçanta dhe situatat konkrete faktike në të cilat aplikohet përgjegjësia penale, në lidhje me to

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	2	2
Të tjera	1	10	10
Ngarkesa totale e orëve			148
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.92
ECTS			6.00